



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

### KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

#### V E N D I M

Nr. 02, datë 27/05/2024

#### **“ PËR SHPALLJEN E AFATIT TË KANDIDIMIT PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, SI DHE ANËTARË TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” ”**

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese, 2024-2028 në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 6, pika 2, neni 18 dhe 25, Vendimin e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit (KZF) nr. 1, datë 24.05.2024 “Për konstituimin dhe zgjedhjen e kryetarit të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit (KZF) të Teknologjisë së Informacionit”, Udhëzimin Nr. 1 datë 23.05.2024 të KIZ-UPT “Për shpalljen e afateve të kandidimit, si dhe dorëzimin e dokumentacionit për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, si dhe anëtarë të komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor””

Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (KZF), në mbledhjen e radhës të zhvilluar më datë 27.05.2024,

#### **V E N D O S I:**

1. Të shpallë periudhën **27.05.2024 – 31.05.2024** si afat për regjistrimin e kandidatëve për autoritetet drejtuese në FTI :
  - 1.1. Drejtuesin e njësisë kryesore (Dekan)
  - 1.2. Drejtuesit e njësive bazë (Përgjegjës Departamenti)
  - 1.3. Anëtarët e komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor” (Këshilli i Profesorëve)
2. Afati i aplikimit të kandidatëve për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, si dhe anëtarë të Komisioneve të Përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, fillon ditën e hënë, datë 27.05.2024, ora 10:00 dhe përfundon ditën e premte, datë 31.05.2024, ora 16:00.
3. Dokumentacioni i kandidimit për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, si dhe anëtarë të Komisioneve të Përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, do të dorëzohet nga ora 10:00-16:00, pranë zyrës së Komisionit Institucional Zgjedhor sipas nenit 25, pika 1 të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese, 2024-2028 në Universitetin Politeknik të Tiranës”.
4. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët dorëzohet në KIZ dhe përmban:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

### KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban:
- emrin;
  - atësinë;
  - mbiemrin;
  - datëlindjen;
  - gjininë;
  - shprehjen e vullnetit për kandidim;
  - deklarin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në UPT;
  - deklarin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
  - deklarin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Kopje të noterizuar të titullit akademik, vetëm për kandidatët për autoritete drejtuese që vijnë nga jashtë UPT-së. Kandidatët që vijnë nga UPT paraqesin vetëm kopjen e gradës/titullit akademik;
- d) Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar.
- e) Deklarimin për antiplagjiaturë në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik sipas formularit bashkëlidhur
- f) Vërtetim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore që ndaj kandidatit nuk është dhënë masë disiplinore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT (KZF – FTI)

1. Alban RAKIPI	Kryetar	<i>Alban Rakiipi</i>
2. Erison BALLASHENI	Anëtar	<i>Erison Ballasheni</i>
3. Ina PAPADHOPULLI	Anëtar	<i>Ina Papadhopulli</i>
4. Paola SHASIVARI	Anëtar	
5. Sidorela BEJDO	Anëtar	<i>Sidorela Bejda</i>

Sekretar: Altina MYDERIZI

*Altina Myderizi*  
*Altina Myderizi*